

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I PARË- SEMESTRI I

Fillet e së Drejtës [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të jenë në gjendje t'i dallojnë format themelore të shtetit dhe së drejtës, të kuptojnë konceptet themelore për shtetin dhe të drejtën, ndërlidhjen e tyre me jetën praktike etj, të aftësohen në nocionet e normës, llojet e saj, rendin juridik, sistemin juridik, interpretimin e normave dhe llojet e interpretimeve, të jenë në gjendje t'i zbatojnë normat juridike, etj.

Historia e Shtetit dhe së Drejtës [O]:

Qëllimet e kësaj lënde janë, që studentët të njohohen me zhvillimin historik të së drejtës dhe shtetit, të institucioneve kryesore shoqërore juridike, të aftësohen në dallimin e formacioneve socio-juridike, do të njihen me zhvillimin historik të pjesëve të veçanta të së drejtës pozitive: civile, penale, administrative, familjare dhe trashëgimore, të aftësohen në logjikën e funksionimit të shtetit dhe të drejtës, në qytetrimet e lashta, në mesjetë dhe në kohën moderne.

Gjuhë Angleze Juridike I [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në gjuhën angleze, për konceptet themelore të disiplinave të juridikut, të komunikojnë, qoftë gojarisht, qoftë me shkrim, të shqyrtojnë modelet e përpunimit të metodave të ndryshme të mësuarit, duke analizuar dhe vlerësuar tekstet e punës, duke aplikuar koncepte dhe teknika konkrete për mësimnxënien e gjuhës angleze.

Sociologji [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të kenë një pasqyrë të gjerë të sociologjisë dhe si të aplikohet ajo në jetën e përditshme, të njohohen me aspektet sociologjike, kulturën, devijimin, pabarazinë, ndryshimin social, strukturat sociale, të aftësohen në menaxhimin e problemeve dhe konflikteve shoqërore dhe të dinë të depërtojnë në brendinë e fenomeneve shoqërore.

Filozofi [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen për së afërmi me konceptet dhe njohuritë e përgjithshme të filozofisë, të krijojnë mendim kritik filozofik duke zgjidhur probleme filozofike, e gjitha, duke i ndërlidhur dy elementet kryesore: ofrimin e informatave mbi nocionet dhe problemet kryesore të filozofisë, të aftësohen në zhvillimin e mendimit analitik mbi botën dhe vetveten.

Logjikë [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë e duhura, mbi shkencën e logjikës, njohuri mbi nocionin, gjykimin, përfundimin, njohjen, të vërtetën, domethënien, emërtimet, shenjat, simbolet, temat, induksionet, deduksionet, analizat, sintezat, abstraktimet, konkretizimet, gjeneralizimet, specializimet, definicionet, argumentimet, etj.

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I PARË - SEMESTRI II

E Drejta Kushtetuese [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me teorinë dhe praktikën e Kushtetutës dhe Sistemit Kushtetues si dhe me institucionet themelore kushtetuese në Republikën e Kosovës. Studentët do të shohin ndërtimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë-parimet bazë të shtetit të së drejtës, të analizojnë në mënyrë të veçantë sistemin aktual kushtetues, në Kosovë, t'i shohin kushtetutat moderne dhe ato të shteteve në tranzicion.

Bazat e Sistemit Gjyqësor [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë e duhura, për sistemin gjyqësor, duke filluar nga hierarkia e tyre, siç janë gjykata kushtetuese, gjykata supreme, gjykata e qarkut, gjykata komunale, gjykata e kundërvajtjes dhe gjykata ekonomike, të shohin mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe kompetencat e sistemit gjyqësor, në Kosovë e më larg.

E Drejta Romake [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të shqyrtojnë sistemin romak ligjor, si origjinë historike e sistemeve modern, në të drejtën civile të Evropës kontinentale. Gjithashtu, do të fokusohen në marrëdhëniet ndërmjet sistemit romak ligjor dhe aspekteve sociale, ekonomike dhe politike të jetës romake. Studentët do të njohohen me historinë e institucioneve juridike romake, burimet e së drejtës, nga 12 tabelat e Justinianit, procedurat, ligjit të personave, kontratave dhe pronës.

Gjuhë Angleze Juridike II [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen sa më shumë në përvetësimin e gjuhës angleze, ndaj koncepteve dhe disiplinave juridike. Përmes këtij kursi, synohet që studentët të avancohen në gjuhën angleze, në të folur dhe në të shkruar, në të gjitha njësitë dhe tekstet që paraqiten gjatë ligjeratave.

Teknologjia Informative Juridike [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas kryerjes së këtij kursi, të jenë në gjendje që njohuritë e shkencës së juridikut t'i kombinojnë me përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informative, duke përdor software të ndryshme me qëllim të lehtësimit të punëve dhe proceseve juridike.

Psikologji Juridike [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të kuptojnë thellësisht psikologjinë e juridikut, aspektet psikologjike të juridikut, aplikimin e qasjes analitike dhe mendimin kritik të koncepteve të ndryshme, duke përfshi kuptimin dhe zbatimin e normës juridike. Në këtë lëndë do të trajtohen konceptet psikologjike të së drejtës duke kundërshtuar qasjet dogmatike të normës juridike.

Etikë Juridike [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të këtij kursi, të fitojnë njohuri juridiko-shkencore dhe me përvoja ditore që ka të bëjë me etikën në përgjithësi e në veçanti me legjislacionin, i cili i referohet etikës së gjyqtarëve, prokurëve dhe avokatëve. Njohjen me parimet bazë të etikës dhe rëndësinë e kësaj fushe në sistemin gjyqsor.